



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 103

Tiranë – E premte, 13 qershor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 11.6.2025	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit tek Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të pronës me emërtimin “Posta e Policisë Kufitare, Vivar”, me numër pasurie 7/555/ND, ndodhur në zonën kadastrale 2297, Sarandë, dhe për kalimin në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të pasurive me numra 7/539 dhe 7/541, ndodhur në zonën kadastrale 2297, Sarandë, si dhe për një shtesë në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....
	14671
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 321, datë 11.6.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 61, datë 29.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i fiderave me kablo 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias”.....
	14681
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 11.6.2025	Për miratimin e kushteve të negociimit të shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a., me shoqëri tregtare private për prodhimin ose përshtatjen e mjeteve motorike të posaçme
	14681
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 323, datë 11.6.2025	Për miratimin e modeleve standarde të autorizimeve, individuale, të përgjithshme e globale, për tregtimin e produkteve, që janë objekt i kontrollit shtetëror, të cilat mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, e të formateve të kërkesave për këto dokumente dhe përcaktimin e afateve, procedurave e tarifave për lëshimin e autorizimeve.....
	14682
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324, datë 11.6.2025	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Arkivit Qendror në Veprim për Dokumentacionin Teknik të Tipologjisë së Veçantë të Armatimit, Pajisjeve Teknologjike Ushtarake të Forcave të Armatosura.....
	14702

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 11.6.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 12, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e nënprojekteve ‘Copëzat’, ‘Hospitality’ dhe ‘Godina e Re e Bibliotekës Kombëtare’, pjesë e projektit të investimit ‘Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore’”	14705
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 11.6.2025	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “ <i>Investment and Development Albania</i> ” sh.p.k., me NUIS L91703053C, si qiramarrës, të pronës së paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8561, Bashkia Korçë, pjesë e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike.....	14710
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 11.6.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 127, datë 3.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”	14717
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 574, datë 9.6.2025	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël.....	14717
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 575, datë 9.6.2025	Për ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi në territorin e Republikës së Shqipërisë.....	14718
	Korrigjim gabimi material në ligjin nr. 47/2024, datë 16.5.2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në fushën e sigurimeve shoqërore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 103, datë 21.6.2024.....	14718



VENDIM
Nr. 320, datë 11.6.2025

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E
TURIZMIT DHE MJEDISIT TEK
DREJTORIA E SHËRBIMEVE
QEVERITARE, TË PRONËS ME
EMËRTIMIN “POSTA E POLICISË
KUFITARE, VIVAR”, ME NUMËR
PASURIE 7/555/ND, NDODHUR NË
ZONËN KADASTRALE 2297, SARANDË,
DHE PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË
SHËRBIMEVE QEVERITARE TË
PASURIVE ME NUMRA 7/539 DHE 7/541,
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE
2297, SARANDË, SI DHE PËR NJË
SHITESË NË VENDIMIN NR. 1058, DATË
16.7.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit te Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të pronës me emërtimin “Posta e Policisë Kufitare, Vivar”, me numër pasurie 7/555/ND, ndodhur në zonën kadastrale 2297,

Sarandë, me qëllim për t’u përdorur në funksion të përmbushjes së veprimtarisë shtetërore, sipas të dhënave të pronës me nr. rendor 1 në formular, kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare të pasurive me numra 7/539 dhe 7/541, ndodhur në zonën kadastrale 2297, Sarandë, me qëllim për t’u përdorur në funksion të përmbushjes së veprimtarisë shtetërore, sipas të dhënave të pronës me numrat rendorë 2 dhe 3 në formular, kartelave të pasurive të paluajtshme dhe hartave kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Pasuritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi i shtohen listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

1. FORMULAR I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Identifikoi pronën: Blerita Tona Shef Sektori Juridik, DSHQ Supervizoi: Emila Xhura Drejtor i DOSHTR, DSHQ Aprovoi: Dhurata Frashëri Drejtor i DSHQ												
Institucioni Qendror Shtetëror: Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare												
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronat/pasuritë	Institucioni me përgjegjësi administrative pronës	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi i pronës përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhena të tjera (Shënime të veçanta)
						Truall (m2)	Ndertesë (m2)					
1	ZK 2297 J-34-4-(208-B)	7/555/ND	Ndertesë	Ish-Posta Policisë Kufitare Vivar			280	Per Shërbime Qeveritare	DSHQ	DSHQ	VKM Nr.12, datë 4.1.2012	
2		7/539	Shesh	Ksamil Vivar	2592				DSHQ	DSHQ		
3		7/541	Shesh		2339				DSHQ	DSHQ		
TOTAL					4931		280					



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2297014248

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2297, Lloji i Pasurisë: SHESH, Nr. i Pasurisë: 7/539, Sipërfaqja Totale 2592 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale J-34-4-(208-B), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia KSAMIL, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT R0000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: P
Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 01053, Datë: 09/07/2013

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektivit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIP T

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIP T

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi:

DREJTORI
Ilir Çibuku

Data e lëshimit 30/05/2025



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe nënshkruar me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)


2/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	<u>2297</u>	KODI UNIK: <u>2297014248</u>
NUMRI I PASURISË:	<u>7/539</u>	INDEKSI I HARTËS: J-34-4-(161- C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 1000

DREJTORI

SHPJEGUES	
	PARCELA
	NDËRTESA



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vëlosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Sarandë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2297014250

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2297, Lloji i Pasurisë: SHESH, Nr. i Pasurisë: 7/541, Sipërfaqja Totale 2339 m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale J-34-4-(208-B), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia KSAMIL, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT R0000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 01053, Datë: 09/07/2013

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektivit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIP T

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIP T

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi:

DREJTORI
Ilir Çibuku

Data e lëshimit 30/05/2025



Shënim : Ky dokument është generuar dhe nënshkruar me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)


2/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	<u>2297</u>	KODI UNIK: <u>2297014250</u>
NUMRI I PASURISË:	7/541	INDEKSI I HARTËS: J-34-4-(161- C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



DREJTORI

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDËRTESA



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vëlosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Sarandë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2297032040

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2297, Lloji i Pasurisë: NDERTESE, Nr. i Pasurisë: 7/555/ND, Sipërfaqja Totale 280 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 280 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale J-34-4-(228-B), Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia SARANDE, Rruga KSAMIL, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. VKM NR. 12, Dt. 04/01/2012), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË _____, Nr. Identifikimi/NIPT R00000000SH, Pjesa Takuese 1/1,

Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia SARANDE, Rruga KSAMIL, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. VKM NR. 12, Datë: 04/01/2012

Regjistruar: Nr. 6292, Datë: 30/05/2025

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NPT
6292	30/05/2025	Administrim	VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit	VKM NR. 12	04/01/2012	99 vite	MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	K51716026T

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: ISH POSTA E POLICISE KUFITARE - VIVAR

DREJTORI
Ilir Çibuku

Data e lëshimit 30/05/2025



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:


2297KODI UNIK: 2297032040

NUMRI I PASURISË:

7/555/ND

INDEKSI I HARTËS: J-34-4-(161-C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 1000

DREJTORI

SHPJEGUES

PARCELA

NDËRTESA



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vëlosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Sarandë)



VENDIM
Nr. 321, datë 11.6.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 61, DATË 29.1.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABLO 20 kV, V4, V5 DHE KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të dhënat e pasurisë me numër rendor 1 të tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 61, datë

29.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i fiderave me kablo 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias”, zëvendësohen me të dhënat e pasurisë me numrin rendor 1 të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrotjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABLO 20 kV, V4, V5 DHE KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS”

Nr.	Nr. i shtyllës	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekare, burime mbi pasuritë, etj.)
												“ARË”/ TRUALL		VLERA TOTALE (lekë)		
		Emër	Atësia	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	K2/V4	Luan	Hysni	Mërkuri	Valias	1649	18/23	Arc	3785.2	18	187	24	5455	130920	130920	

VENDIM
Nr. 322, datë 11.6.2025

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË NEGOCIIMIT TË SHOQËRISË SHTETËRORE “KAYO” SHA, ME SHOQËRI TREGTARE PRIVATE PËR PRODHIMIN OSE PËRSHTATJEN E MJETEVE MOTORIKE TË POSAÇME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe

teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrotjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt miratimin e kushteve të negociimit të shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a., me shoqëri tregtare private, me qëllim krijimin e një shoqërie aksionare të përbashkët, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim, me qëllim, mes të tjerave, prodhimin ose përshtatjen e mjeteve motorike të posaçme për t’u përdorur nga Forcat e



Armatosura të Republikës së Shqipërisë, strukturat e sigurisë dhe të emergjencave civile.

2. Shoqëria “KAYO” sh.a. do të ketë një pjesëmarrje jo më të ulët se 45% të aksioneve në shoqërinë e përbashkët, që do të krijojë me shoqëri private, sipas këtij vendimi.

3. Shoqëria “KAYO” sh.a. do të kontribuojë në entitetin e ri tregtar, me pasuri të paluajtshme, në masën jo më pak se 20 000 m², që do t'i vihen në përdorim shoqërisë së përbashkët, në një nga format e parashikuara nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, pa të drejtë tjetërsimi.

4. Shoqëria “KAYO” sh.a., gjatë procesit të negociimit, në çdo rast, siguron nga subjekti me të cilin negocion, minimalisht:

a) një vlerë investimi jo më të ulët se 15 milionë euro në harkun kohor të 3 (tre) vjetëve;

b) punësimin e jo më pak se 150 (njëqind e pesëdhjetë) punonjësve në harkun kohor të 3 (tre) vjetëve;

c) ofrimin e linjave teknologjike të prodhimit të mjeteve të blinduara, sipas nevojave operacionale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të standardeve të NATO-s;

ç) sigurimin e rrjetit të shpërndarjes së produkteve, në rast eksporti.

5. Shoqëria “KAYO” sh.a., siguron nga pala tjetër, gjatë negociatave, se, përpos parashikimeve të tjera, objekti i aktivitetit të shoqërisë tregtare, që do të krijohet, do të përmbajë prodhimin dhe tregtimin e mjeteve ushtarake dhe mjeteve për përdorim nga strukturat e sigurisë e të emergjencave civile.

6. Shoqëria “KAYO” sh.a., siguron nga pala tjetër, gjatë negociatave, se administratori/ët i/e shoqërisë, që do të krijohet nga dy shoqëritë e sipërcituara, zgjidhen/t me dakordësinë e shoqërisë “KAYO” sh.a.

7. Shoqëria “KAYO” sh.a., siguron nga pala tjetër, gjatë negociatave, se minimalisht 50% e këshillit drejtues ose këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, që do të krijohet, në rast se forma e shoqërisë parashikon këto organe drejtuese/ mbikëqyrëse, do të emërohen nga shoqëria “KAYO”, sh.a.

8. Statuti i shoqërisë, që do të krijohet, përmban dispozitat mbi të drejtën e vetos, që gëzon shoqëria “KAYO” sh.a., në bazë të pikës 9, të nenit 10, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.

9. Shoqëria “KAYO” sh.a., gjatë negociatave ofron nëpërmjet strukturave të ruajtjes dhe sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë garancinë e sigurisë fizike të ambienteve të prodhimit të mjeteve ushtarake, të dhënat teknike dhe tregtare në lidhje me këto mjete dhe sigurimin e çdo informacioni teknik dhe projektimi të këtyre mjeteve, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre.

10. Autorizohen shoqëria “KAYO” sh.a., dhe shoqëria private, me të cilën do të bashkëpunojë, të furnizojnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë me mjetet që do të prodhohen nëpërmjet shoqërisë që do të krijohet, në përputhje me këtë vendim.

11. Ngarkohet shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 323, datë 11.6.2025

**PËR MIRATIMIN E MODELEVE
STANDARDE TË AUTORIZIMEVE,
INDIVIDUALE, TË PËRGJITHSHME E
GLOBALE, PËR TREGTIMIN E
PRODUKTEVE, QË JANË OBJEKT I
KONTROLLIT SHTETËROR, TË CILAT
MUND TË PËRDOREN PËR DËNIME
ME VDEKJE, TORTURË OSE DËNIME
APO TRAJTIME MIZORE, ÇNJERËZORE
OSE POSHTËRUESE, E TË FORMATEVE
TË KËRKESAVE PËR KËTO
DOKUMENTE DHE PËRCAKTIMIN E
AFATEVE, PROCEDURAVE E TARIFAVE
PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 17, të ligjit nr. 27/2023, “Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjërëzore apo poshtëruese”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij vendimi është miratimi i modeleve standarde të autorizimeve, tarifave të autorizimeve, formateve të kërkesave për këto dokumente, si dhe afateve dhe procedurave për lëshimin e të tria llojeve të autorizimeve për produktet, që janë objekt i kontrollit shtetëror, të cilat mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Qëllimi i këtij vendimi është formalizimi dhe standardizimi i procesit të lëshimit të autorizimeve, të cilat jepen në përputhje me ligjin nr. 27/2023, “Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese”.

II. MODELET STANDARDE TË AUTORIZIMEVE, TARIFAT E AUTORIZIMEVE DHE FORMATET E KËRKESAVE

3. Modelet standarde të dokumentacionit për autorizimet individuale/të përgjithshme/globale për eksportin, importin, transitin, ofrimin e ndihmës teknike dhe veprimtaritë ndërmjetësuese, të lëshuara nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (në vijim, AKSHE), janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Tarifa e aplikimit për të gjitha llojet e autorizimeve është 3000 (tre mijë) lekë. Kjo tarifë derdhet në buxhetin e shtetit.

5. Formatet e kërkesave dhe të autorizimeve janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. AFATET DHE PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMEVE

6. Personi fizik/juridik privat ose publik paraqet kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues për t'u pajisur me autorizimin përkatës pranë AKSHE-së nëpërmjet portalit *e-Albania*.

7. Operatorët ekonomikë shprehin interesin për kategoritë e mallrave dhe shtetet, të cilat kërkojnë t'i përfshijnë në licencë të përgjithshme.

8. AKSHE-ja, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës nga operatori ekonomik, verifikimit të dokumentacionit, si dhe verifikimit të kushteve të përcaktuara në nenin 9, të ligjit nr. 27/2023, në një afat kohor brenda 20 (njëzet) ditëve punë, vendos lëshimin ose refuzimin e kërkesës.

9. Në rastet kur AKSHE-ja konstaton që aplikimi ka mangësi në dokumentacion, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga marrja në dorëzim e kërkesës, i njofton operatorit ekonomik, nëpërmjet portalit *e-Albania*, kërkesën për plotësim dokumentacioni. Komunikimi për plotësimin e mangësive të konstatuara pezullon afatet e shqyrtimit të kërkesës.

10. Nga momenti i njoftimit për plotësimin e mangësive të konstatuara, operatori ekonomik ka 5 (pesë) ditë pune kohë për të plotësuar mangësitë e konstatuara, në të kundërt kërkesa do të konsiderohet e refuzuar. Për këtë, operatori ekonomik njoftohet nëpërmjet portalit *e-Albania*.

11. Në rastin e plotësimit të mangësive të konstatuara, AKSHE-ja shqyrton kërkesën, verifikon dokumentacionin dhe vendos lëshimin ose refuzimin e kërkesës, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 8 të këtij vendimi.

12. AKSHE-ja bashkëpunon me institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 27/2023, duke marrë mendim dhe informacion për operatorët ekonomikë, që paraqesin kërkesat për pajisjet me autorizim pranë tij, sipas fushave të përgjegjësisë.

13. Autorizimi i përgjithshëm miratohet pas konsultimit me grupet e interesit (operatorët ekonomikë në transferimin e mallrave që mund të përdoren për qëllime torture apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese), si dhe me institucionet e përmendura në pikën 2, të nenit 24, të ligjit nr. 27/2023.

14. Informacioni i dërguar nga institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera bëhet pjesë përbërëse e vlerësimit përfundimtar nga AKSHE-ja, mbi bazën e të cilit merret vendimi për lëshimin ose refuzimin e aplikimit.

15. AKSHE-ja, në përfundim të procesit të konsultimit, vendos lëshimin ose refuzimin e autorizimit të përgjithshëm, duke përcaktuar kategoritë e mallrave dhe shtetet importuese.

16. Vendimi për lëshimin ose refuzimin e aplikimit i njoftohet operatorit ekonomik nëpërmjet portalit *e-Albania*.

17. Autorizimi i përgjithshëm për eksport, për mallrat që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, lëshohet nga AKSHE-ja për një afat 3-vjeçar dhe mund të përdoret nga të gjithë personat fizikë/juridikë, të cilët veprojnë në përputhje me kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga ky akt, si dhe në përputhje me



Lidhja nr.1

kushtet e përcaktuara në autorizimin e përgjithshëm për dërgimin e mallrave në shtetet që janë listuar në autorizim.

18. Autorizimi individual për import, eksport, transit, ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit dhe për ndihmën teknike lëshohet nga AKSHE-ja për një afat 1-vjeçar dhe mund të përdoret për disa transferta brenda vlefshmërisë së autorizimit ose deri sa të mbarojë sasia e mallrave në autorizim.

19. Autorizimi global për import, eksport, transit, ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit dhe për ndihmën teknike lëshohet nga AKSHE-ja për një afat 2-vjeçar dhe mund të përdoret për disa transferta brenda vlefshmërisë së autorizimit ose deri sa të mbarojë sasia e mallrave në autorizim.

20. Operatori ekonomik ka të drejtë të ankimojë vendimin e AKSHE-së, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

21. AKSHE-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, është e detyruar të ruajë informacionin e klasifikuar, konfidencialitetin e të dhënave dhe sekretet tregtare të subjekteve të përfshira, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

22. Paraqitja e kërkesave dhe plotësimi i dokumentacionit nga ana e subjekteve sipas parashikimit të pikave 6 dhe 10, të këtij vendimi, si dhe detyrimi i AKSHE-së për të kryer njoftimet dhe vendimarrjen sipas pikave 8 deri 10 dhe pikës 16, të këtij vendimi, nëpërmjet portalit *e-Albania*, hyn në fuqi pas përfundimit të zhvillimeve teknike të trajtimit të aplikimeve në sistemin e përmirësuar të menaxhimit të informacionit për AKSHE-në. Deri në përfundimin e zhvillimeve teknike, paraqitja e kërkesës dhe plotësimi i dokumentacionit nga ana e subjekteve, si dhe njoftimet për vendimarrjen nga ana e AKSHE-së do të kryhen nëpërmjet shërbimit postar.

23. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MODELET STANDARDE TË AUTORIZIMEVE

1. Autorizim individual për ndihmë teknike për mallra, të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Autorizim individual transiti për mallra, të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

3. Autorizim individual eksporti për mallra, të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

4. Autorizim individual importi për mallra, të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

5. Autorizim individual/global për veprimtari ndërmjetësuese për mallra, që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera, apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

6. Autorizim individual/global eksporti për mallra, që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera, apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

7. Autorizim individual/global për ndihmë teknike për mallra, që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera, apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

8. Autorizim i përgjithshëm eksporti për mallra, që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera, apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

9. Autorizim individual/global për veprimtari ndërmjetësuese për mallra, që mund të përdoren për qëllim të dënimit me vdekje.

10. Autorizim individual/global eksporti për mallra, që mund të përdoren për qëllim të dënimit me vdekje.

11. Autorizim individual/global për ndihmë teknike për mallra, që mund të përdoren për qëllim të dënimit me vdekje.



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË (REPUBLIC OF ALBANIA) MINISTRIA E MBROJTJES (MINISTRY OF DEFENCE) AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE -A.K.S.H.E - (STATE EXPORT CONTROL AUTHORITY)		AUTORIZIM PËR NDIHMË TEKNIKE TECHNICAL ASSISTANCE AUTHORISATION				
		Mallra të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese; (Goods which have no other use than for capital punishment, torture or as cruel, inhuman or degrading treatment or punishment)				
☐ INDIVIDUALE (INDIVIDUAL)	1. Ofruesi i ndihmës teknike <i>(Technical assistance provider)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> Emri i bankës <i>(Bank name)</i> Llogaria bankare <i>(Bank account)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i> Faqja e internetit <i>(Website)</i>		4. Shteti i origjinës <i>(Country of origin)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>	5. Shteti Importues <i>(Importing country)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>
	2. Marrësi i ndihmës teknike <i>(Technical assistance receiver)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i>		6. Shteti i destinacionit të fundit <i>(Destination country)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>	7. Qëllimi i përdorimit të fundit <i>(End use purpose)</i>	
	3. Palë të treta të përfshira <i>(Third Parties Involved)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i>		8. Përdoruesi i fundit <i>(End user)</i>		9. Përshkrimi i ndihmës teknike <i>(Description of technical assistance)</i>	
			10. Mënyra e pagesës <i>(Payment terms)</i>			
	11. Vlefshmëria e kërkuar <i>(Validity requested)</i>		12. Monedha e pagesës <i>(Currency of payment)</i>		Kodi i monedhës <i>(Currency code)</i>	
13. Përshkrimi i mallrave <i>(Description of goods)</i>		14. Kodi tarifor doganor i mallit <i>(Customs tariff code no.)</i>	15. Sasia <i>(Quantity)</i>		16. Vlera në monedhën e pagesës <i>(value in currency of payment)</i>	
			Njesia <i>(Unit)</i>	Shifra <i>(Amount)</i>		
17. Totali <i>(Total)</i>						
☐ LLOJI I AUTORIZIMIT (AUTHORISATION TYPE)	18. Administratori/Përfqyesuesi ligjor <i>(Administrator/ Legal representative)</i>					
	AUTORIZIM (AUTHORISATION) VLEFSHMËRIA DERI MË: (VALIDITY UNTIL): VULA (STAMP) Nr. (No) KRYETARI (CHAIRMAN) Data (Date) Data (Date)					



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË (REPUBLIC OF ALBANIA) MINISTRIA E MBROJTJES (MINISTRY OF DEFENCE) AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE -A.K.S.H.E - (STATE EXPORT CONTROL AUTHORITY)		AUTORIZIM PËR NDIHMË TEKNIKE TECHNICAL ASSISTANCE AUTHORISATION				
		☐ Mallra që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. <i>(Goods which could be used for torture or other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment.)</i> ☐ Mallra që mund të përdoren për qëllim të dënimit me vdekje. <i>(Goods which could be used for capital punishment.)</i>				
☐ GLOBALE (GLOBAL)	1. Ofuesi i ndihmës teknike <i>(Technical assistance provider)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> Emri i bankës <i>(Bank name)</i> Llogaria bankare <i>(Bank account)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i> Faqja e internetit <i>(Website)</i>		4. Shteti i origjinës <i>(Country of origin)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>	5. Shteti Importues <i>(Importing country)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>
	2. Marrësi i ndihmës teknike <i>(Technical assistance receiver)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i>		6. Shteti i destinacionit të fundit <i>(Destination country)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>	7. Qëllimi i përdorimit të fundit <i>(End use purpose)</i>	
☐ INDIVIDUALE (INDIVIDUAL)	3. Palë të treta të përfshira <i>(Third Parties Involved)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i>		8. Përdoruesi i fundit <i>(End user)</i>		9. Përshkrimi i ndihmës teknike <i>(Description of technical assistance)</i>	
	11. Vlefshmëria e kërkuar <i>(Validity requested)</i>		12. Monedha e pagesës <i>(Currency of payment)</i>		Kodi i monedhës <i>(Currency code)</i>	
	13. Përshkrimi i mallrave <i>(Description of goods)</i>	14. Kodi tarifor doganor i mallit <i>(Customs tariff code no.)</i>	15. Sasia <i>(Quantity)</i>		16. Vlera në monedhën e pagesës <i>(value in currency of payment)</i>	
			Njesia <i>(Unit)</i>	Shifra <i>(Amount)</i>		
17. Totali <i>(Total)</i>						
LLOJI I AUTORIZIMIT (AUTHORISATION TYPE)	18. Administratori/ Përfaqësuesi ligjor <i>(Administrator/ Legal representative)</i>					
	AUTORIZIM (AUTHORISATION) VLEFSHMËRIA DERI MË: (VALIDITY UNTIL): VULA (STAMP) Nr. (No) Data (Date) Data (Date) KRYETARI (CHAIRMAN)					



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË (REPUBLIC OF ALBANIA) MINISTRIA E MBROJTJES (MINISTRY OF DEFENCE) AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE -A.K.S.H.E - (STATE EXPORT CONTROL AUTHORITY)		AUTORIZIM PËR VEPRIMTARI NDËRMJETËSUESE AUTHORISATION FOR BROKERING ACTIVITIES				
		☐ Mallra që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. <i>(Goods which could be used for torture or other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment.)</i> ☐ Mallra që mund të përdoren për qëllim të dënimit me vdekje. <i>(Goods which could be used for capital punishment.)</i>				
☐ GLOBALE (GLOBAL)	1. Ndërmjetësuesi <i>(Broker)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> Emri i bankës <i>(Bank name)</i> Llogaria bankare <i>(Bank account)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i> Faqja e internetit <i>(Website)</i>		4. Shteti i origjinës <i>(Country of origin)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>	5. Shteti i importues <i>(Importing country)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>
	2. Eksportuesi <i>(Exporter)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i>		6. Shteti i destinacionit të fundit <i>(Destination country)</i>		Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>	7. Vendet tranzit/tranship <i>(Transit/tranship country)</i>
☐ INDIVIDUALE (INDIVIDUAL)	3. Importuesi <i>(Importer)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i>		8. Përdoruesi i fundit <i>(End user)</i>		9. Qëllimi i përdorimit të fundit <i>(End use purpose)</i>	
			10. Mënyra e pagesës <i>(Payment terms)</i>			
	11. Vlefshmëria e kërkuar <i>(Validity requested)</i>		12. Monedha e pagesës <i>(Currency of payment)</i>		Kodi i monedhës <i>(Currency code)</i>	
	13. Përshkrimi i mallrave <i>(Description of goods)</i>	14. Kodi tarifor doganor i mallit <i>(Customs tariff code no.)</i>	15. Sasia <i>(Quantity)</i>		16. Vlera në monedhën e pagesës <i>(value in currency of payment)</i>	
			Nësia <i>(Unit)</i>	Shifra <i>(Amount)</i>		
17. Totali <i>(Total)</i>						
☐ LLOJI I AUTORIZIMIT (AUTHORISATION TYPE)	18. Administratori/Përfaqësuesi ligjor <i>(Administrator/ Legal representative)</i>					
	AUTORIZIM (AUTHORISATION) VLEFSHMËRIA DERI MË: (VALIDITY UNTIL): VULA (STAMP) Nr. (No) Data (Date) Data (Date) KRYETARI (CHAIRMAN)					



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË (REPUBLIC OF ALBANIA) MINISTRIA E MBROJTJES (MINISTRY OF DEFENCE) AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE -A.K.S.H.E - (STATE EXPORT CONTROL AUTHORITY)		AUTORIZIM EKSPORTI EXPORT AUTHORISATION				
		☐ Mallra që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çjerëzore ose poshtëruese. <i>(Goods which could be used for torture or other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment.)</i> ☐ Mallra që mund të përdoren për qëllim të dënimit me vdekje. <i>(Goods which could be used for capital punishment.)</i>				
☐ GLOBALE (GLOBAL)	1. Eksportuesi <i>(Exporter)</i> Adresa <i>(Address)</i> Telefoni <i>(Telephone)</i> Emri i bankës <i>(Bank name)</i> Llogaria bankare <i>(Bank account)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i> Faqja e internetit <i>(Website)</i>		4. Brokëri/agjenti (nëse ka) <i>(Broker/agent (if exists))</i>			
	2. Importuesi <i>(Importer)</i> Adresa <i>(Address)</i> NIPT <i>(Fiscal code)</i>		5. Shteti i origjinës <i>(Country of origin)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>	6. Shteti Importues <i>(Importing country)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>
			7. Shteti i destinacionit të fundit <i>(Destination country)</i>	Kodi i shtetit <i>(Country code)</i>	8. Vendet tranzit/tranship <i>(Transit/tranship country)</i>	
			9. Mënyra e transportit <i>(Mean of transport)</i>		10. Kushtet e shpërndarjes <i>(Delivery terms)</i>	
☐ INDIVIDUALE (INDIVIDUAL)	3. Furnizuesi <i>(Supplier)</i>		13. Mënyra e pagesës <i>(Payment terms)</i>			
	14. Vlefshmëria e kërkuar <i>(Validity requested)</i>		15. Monedha e pagesës <i>(Currency of payment)</i>		Kodi i monedhës <i>(Currency code)</i>	
	16. Përshkrimi i mallrave <i>(Description of goods)</i>	17. Kodi tarifor doganor i mallit <i>(Customs tariff code no.)</i>	18. Sasia <i>(Quantity)</i>		19. Vlera në monedhën e pagesës <i>(value in currency of payment)</i>	
			Njesia <i>(Unit)</i>	Shifra <i>(Amount)</i>		
	20. Totali <i>(Total)</i>					
☐ LLOJ I AUTORIZIMIT (AUTHORISATION TYPE)	21. Pika Doganore <i>(Customs office)</i>		22. Administratori/Përfaqësuesi ligjor <i>(Administrator/ Legal representative)</i>			
	AUTORIZIM (AUTHORISATION) VLEFSHMËRIA DERI MË: (VALIDITY UNTIL): VULA (STAMP) Nr. (No.) KRYETARI (CHAIRMAN) Data (Date) Data (Date)					



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË (REPUBLIC OF ALBANIA) MINISTRIA E MBROJTJES (MINISTRY OF DEFENCE) AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE -A.K.S.H.E - (STATE EXPORT CONTROL AUTHORITY)		AUTORIZIM I PËRGJITHSHËM EKSPORTI GENERAL EXPORT AUTHORISATION											
		Mallra që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. <i>(Goods which could be used for torture or other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment.)</i>											
PËRGJITHSHËM (General)	1. Eksportuesi (Exporter) Adresa (Address) Telefoni (Telephone) Emri i bankës (Bank name) Llogaria bankare (Bank account) NIPT (Fiscal code) Faqja e internetit (Website)		4. Brokteri/agenti (nëse ka) (Broker/agent (if exists))										
			5. Shteti i origjinës (Country of origin)	Kodi i shtetit (Country code)	6. Shteti / Shtetet Importuese (Importing countries)								
			7. Shteti/Shtetet e destinacionit të fundit (Destination country/ies)	Kodi i shtetit (Country code)	8. Vendet tranzit/tranship (Transit/tranship country)								
	2. Importuesi (Importer)		9. Mënyra e transportit (Mean of transport)		10. Kushtet e shpërndarjes (Delivery terms)								
	Adresa (Address) NIPT (Fiscal code)		11. Përdoruesi i fundit (End user)		12. Qëllimi i përdorimit të fundit (End use purpose)								
	3. Furnizuesi (Supplier)		13. Mënyra e pagesës (Payment terms)										
	14. Vlefshmëria e kërkuar (Validity requested)		15. Monedha e pagesës (Currency of payment)		Kodi i monedhës (Currency code)								
	16. Përshkrimi i mallrave (Description of goods)	17. Kodi Doganor i mallit (Customs tariff code no.)	18. Sasia (Quantity)		19. Vlera në monedhën e pagesës (Value in currency of payment)								
			Njesia (Unit)	Shifra (Amount)									
	20. Totali (Total)												
LLOJI I AUTORIZIMIT (AUTHORISATION TYPE)	21. Pika Doganore (Customs office)		22. Administratori/ Përfaqësuesi ligjor (Administrator/ Legal representative)										
	<table border="0"> <tr> <td>AUTORIZIM (AUTHORISATION)</td> <td>Nr. (No)</td> <td>Data (Date)</td> </tr> <tr> <td>VLEFSHMËRIA DERI MË: (VALIDITY UNTIL):</td> <td></td> <td>Data (Date)</td> </tr> <tr> <td>VULA (STAMP)</td> <td colspan="2">KRYETARI (CHAIRMAN)</td> </tr> </table>					AUTORIZIM (AUTHORISATION)	Nr. (No)	Data (Date)	VLEFSHMËRIA DERI MË: (VALIDITY UNTIL):		Data (Date)	VULA (STAMP)	KRYETARI (CHAIRMAN)
AUTORIZIM (AUTHORISATION)	Nr. (No)	Data (Date)											
VLEFSHMËRIA DERI MË: (VALIDITY UNTIL):		Data (Date)											
VULA (STAMP)	KRYETARI (CHAIRMAN)												



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË (REPUBLIC OF ALBANIA) MINISTRIA E MBROJTJES (MINISTRY OF DEFENCE) AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE -A.K.S.H.E - (STATE EXPORT CONTROL AUTHORITY)		AUTORIZIM EKSPORTI EXPORT AUTHORISATION					
		Mallra të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese; (Goods which have no other use than for capital punishment, torture or other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment)					
1. Eksportuesi (Exporter) Adresa (Address) Telefoni (Telephone) Emri i bankës (Bank name) Llogaria bankare (Bank account) NIPT (Fiscal code) Faqja e internetit (Website)	2. Importuesi (Importer) Adresa (Address) NIPT (Fiscal code)	4. Brokeri/agenti (nëse ka) (Broker/agent (if exists))		5. Shteti i origjinës (Country of origin)	Kodi i shtetit (Country code)	6. Shteti Importues (Importing country)	Kodi i shtetit (Country code)
		7. Shteti i destinacionit të fundit (Destination country)		Kodi i shtetit (Country code)	8. Vendet tranzit/tranship (Transit/tranship country)		
		9. Mënyra e transportit (Mean of transport)		10. Kushtet e shpërndarjes (Delivery terms)			
		11. Përdoruesi i fundit (End user)		12. Qëllimi i përdorimit të fundit (End use purpose)			
INDIVIDUALE (INDIVIDUAL)		3. Furnizuesi (Supplier)		13. Mënyra e pagesës (Payment terms)			
		14. Vlefshmëria e kërkuar (Validity requested)		15. Monedha e pagesës (Currency of payment)		Kodi i monedhës (Currency code)	
		16. Përshkrimi i mallrave (Description of goods)	17. Kodi tarifor doganor i mallit (Customs tariff code no.)	18. Sasia (Quantity)		19. Vlera në monedhën e pagesës (value in currency of payment)	
				Njesia (Unit)	Shifra (Amount)		
		20. Totali (Total)					
LLOJI I AUTORIZIMIT (AUTHORISATION TYPE)		21. Pika Doganore (Customs office)		22. Administratori/ Përfaqësuesi ligjor (Administrator/ Legal representative)			
		AUTORIZIM (AUTHORISATION) VLEFSHMËRIA DERI MË: (VALIDITY UNTIL): VULA (STAMP) Nr. (No.) Data (Date) Data (Date) KRYETARI (CHAIRMAN)					



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË (REPUBLIC OF ALBANIA) MINISTRIA E MBROJTJES (MINISTRY OF DEFENCE) AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE -A.K.S.H.E - (STATE EXPORT CONTROL AUTHORITY)		AUTORIZIM IMPORTI IMPORT AUTHORISATION		
		Mallra të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese; <i>(Goods which have no other use than for capital punishment, torture or other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment)</i>		
	1. Importuesi (Importer)	4. Brokeri/agenti (nëse ka) (Broker/agent (if exists))		
2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1 PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e pasurisë (m ²)	Institucioni me pronësi / përgjegjësi administrimi
1	8270	4/855	217	shtet
2	8270	4/114	598	shtet
3	8270	4/861	947.35	shtet
4	8270	4/860	0.95	shtet
5	8270	4/443	29	shtet
6	8270	4/450	5	shtet
7	8270	4/112	697.5 (nga e cila kalon në pronësi vetëm pjesa prej 96.96 m ² sipas planit të rievimit bashkëlidhur)	shtet
8	8270	4/113	65.1 (nga e cila kalon në pronësi vetëm pjesa prej 15.32 m ² sipas planit të rievimit bashkëlidhur)	shtet
9	8270	4/119	904 (nga e cila kalon në pronësi vetëm pjesa prej 115.64 m ² sipas planit të rievimit bashkëlidhur)	shtet



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE 09/06/2025		QELLIMI: Inventarizim																																				
VENDNDODHJA BASHKIA: Tirane		DVASHK/ZVASHK : Tirane		ZONA KADASTRALE :8270																																				
TE DHENAT E PASURISE		NUMRI PASURISE : 4/112		INDEX HARTE : TR;T-11																																				
LLOJI PASURISE : Rruge		SIP.PASURISE =697.5m2		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT =0m2																																				
		NUMRI KATEVE _____		NUMRI PEMEVE _____																																				
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X 484801.792 Y 4575778.164 X 484898.608 Y 4575779.280 4/88 16 189 SHPJEGUES PER INVENTARIZIM PJESE NGA PASURIA 4/112= 96.96m2 X 484802.530 Y 4575714.079 SH 1:500 X 484899.347 Y 4575715.195																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Veri</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Jug</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Lindje</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Perendim</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	Veri						2	Jug						3	Lindje						4	Perendim					
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	Veri																																							
2	Jug																																							
3	Lindje																																							
4	Perendim																																							
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: Ersi Çela KOMPANIA: Person Fizik Ersi Çela Digitally signed by Ersi Çela Date: 2025.06.09 09:14:26 +02'00' NENSHKRIMI/VULA _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI / VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: NENSHKRIMI: _____																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE 09/06/2025		QELLIMI: Inventarizim																																				
VENDNDODHJA BASHKIA: Tirane DVASHK/ZVASHK : Tirane ZONA KADASTRALE: 8270 NUMRI PASURISE: 4/113 INDEX HARTE: TR;T-11																																								
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: Trotuare SIP.PASURISE=65.1m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=0m2 NUMRI KATEVE _____ NUMRI PEMEVE _____																																								
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X 484815.240 Y 4575772.214				X 484912.057 Y 4575773.330																																				
SHPIEGUES PER INVENTARIZIM PJESE NGA PASURIA 4/113= 15.32m2																																								
X 484741.624 Y 4575699.971		SH 1:500		X 484838.441 Y 4575701.086																																				
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 5%;">Nr.</th> <th style="width: 20%;">ORIENTIMI</th> <th style="width: 15%;">PERDORIMI</th> <th style="width: 15%;">TIPI KUFIRIT</th> <th style="width: 15%;">KUFITARI</th> <th style="width: 10%;">ID/NIPT</th> <th style="width: 20%;">SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Veri</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Jug</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Lindje</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Perendim</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	Veri						2	Jug						3	Lindje						4	Perendim					
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	Veri																																							
2	Jug																																							
3	Lindje																																							
4	Perendim																																							
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: Ersi Çela Enri çela Digital signed by Enri çela Date: 2025.06.09 10:16:27 +02'00' KOMPANIA: Person Fizik NENSHKRIMI/VULA _____ REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI / VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: NENSHKRIMI: _____																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET

DATE 09/06/2025

QELLIMI: Inventarizim

VENDNDODHJA

BASHKIA: Tirane

DVASHK/ZVASHK : Tirane

ZONA KADASTRALE:8270

NUMRI PASURISE: 4/119

INDEX HARTE: TR;T-11

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: Rruge

SIP.PASURISE=904m2


SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=0m2

NUMRI KATEVE

NUMRI PEMEVE

X 484740.886
Y 4575764.055

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 484837.702
Y 4575765.171X 401048.428
Y 4574527.723

SH 1:500

X 401145.224
Y 4574527.723

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	Veri					
2	Jug					
3	Lindje					
4	Perendim					

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: Ersi Çela

KOMPANIA: Person Fizik
Ersi Çela

NENSHKRIMI/VULA

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI

DVASHK

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI:

NENSHKRIMI:

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



VENDIM
Nr. 327, datë 11.6.2025

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË,
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,
NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, KULTURËS DHE
INOACIONIT, SI QIRADHËNËS, DHE
SHOQËRISË “INVESTMENT AND
DEVELOPMENT ALBANIA” SHPK, ME
NUIS L91703053C, SI QIRAMARRËS, TË
PRONËS SË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË ZONËN
KADASTRALE NR. 8561, BASHKIA
KORÇË, PJSË E FONDIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN
E INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3.1, të kreut V, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 (një) euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Investment and Development Albania”, sh.p.k., me NUIS L91703053C, si qiramarrës, për pronën e paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8561, me numër pasurie 1/911, të llojit “truall”, me sipërfaqe totale 10 000 (dhjetë mijë) m², në pronësi “shtet”, me vendndodhje Bashkia Korçë, pjesë e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, sipas dokumentacionit të pronësisë, rilevimit topografik dhe tekstit të projektkontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe shoqëria “Investment and Development Albania” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ Rep. Nr. _____ Kol.

KONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata

Në Tiranë, sot më _____, të muajit _____, të vitit _____, (_____), u paraqitën para meje, noterit _____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIPT/NUIS J91326001G, përfaqësuar me autorizim të titullarit të institucionit “Qiradhënëse”, nr. _____ nga z./znj. _____, me detyrë _____, në (institucionin “Qiradhënëse”), i datëlindjes _____._____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letër njoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet

“QIRADHËNËSI”

dhe

Subjekti investues strategjik “Investment and Development Albania” sh.p.k., regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja, me NIPT/NUIS L91703053C, me seli qendrore në _____, me adresë: _____, përfaqësuar nga z./znj. _____, i biri/bija i/e _____, i datëlindjes _____._____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi _____, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet

“QIRAMARRËSI”.

Bazuar në:

- Vendimin nr. 29/4, datë 1.2.2023, “Për miratimin e statusit “Investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit “Green House Korça Resort” me subjekt aplikues “Investment and Development Albania” sh.p.k., NUIS L91703053C.

- Vendimin nr. 433, datë 19.7.2023, “Për transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për



mbështetjen e investimeve strategjike për vënien në dispozicion të investitorit strategjik të pronës së paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8561, Bashkia Korçë, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Green House Korça Resort”.

- Në nenet 801–825 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

- Ligji nr. 55/2025, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me kontratë qiraje 1 euro e pasurisë shtetërore: “truall” me sipërfaqe totale 10,000 m², me numër pasurie 1/911, në zonën kadastrale nr. 8561, në administrim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, transferuar në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, me vendimin nr. 433/2023, të Këshillit të Ministrave, me vendndodhje Bashkia Korçë, sipas rilevimit topografik dhe dokumentit të ASHK-së, bashkëlidhur kontratës.

Neni 2

Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për realizimin e projektit investues strategjik “Green House Korça Resort”.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për 20 vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 Qiradhënësi, nëpërmjet strukturës përgjegjëse të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dorëzon brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e Qiramarrësit.

4.3 Qiradhënësi ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, të monitorojë nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 Qiradhënësi është i detyruar të garantojë Qiramarrësin për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 Qiramarrësi ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 Qiramarrësi ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 Qiramarrësi detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në aplikimin e bërë pranë AIDA për statusin e investitorit strategjik dhe në dokumentacionin pjesë integrale e kësaj kontrate.

5.4 Qiramarrësi detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 Qiramarrësi” detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 Qiramarrësi detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Green House Korça Resort”, në vlerën 18,106,741 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzet e një) euro (me TVSH) dhe do të përfundojë brenda 30 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjeve të lejeve përkatëse për punimet.



Sipas plan biznesit të paraqitur, ndërtimi i një hoteli luksoz me 5*, i cili do të jetë me 5 kate dhe do të ketë në total 94 dhoma.

Ky investim do të realizohet si vijon:

Faza I: Vlera 8.109.707 (tetë milionë e njëqind e nëntë mijë e shtatëqind e shtatë) euro;

Faza II: Vlera 8.026.674 (tetë milionë e njëzetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) euro;

Faza III: Vlera 1.970.360 (një milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë).

5.8 Qiramarrësi, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në plan biznesin e paraqitur do të punësojë minimalisht 94 punonjës me përfundimin e investimit ku në fazën e parë parashikohen të punësohen 23 punonjës, në fazën e dytë 22 punonjës dhe në fazën e tretë 48 punonjës. Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar, transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

Qiramarrësi detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

5.9 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.10 Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te Qiradhënësi në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga audituesi, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.11 Qiramarrësi detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.12 Qiramarrësi, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga Qiramarrësi.

5.13 Në ngarkim të Qiramarrësit janë të gjitha

tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.14 Qiramarrësit nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nënqira ose t’ia kalojë kontratën një tjetri.

5.15 Qiramarrësi në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

Neni 6

Pagesa e qirasë

6.1 Qiramarrësi detyrohet t’i paguajë Qiradhënësit detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro.

6.1.1 Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata, sipas faturës të lëshuar nga Qiradhënësi.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës Qiramarrësi detyrohet të paguajë garancinë e kontratës, e cila është e barabartë me vlerën 2% e vlerës së investimit, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të kësaj kontrate qiraje.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, Qiramarrësi do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e Qiradhënësit sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

Penalitetet

7.1 Në rastin kur Qiramarrësi, në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, Qiradhënësi zgjidh kontratën dhe gjobit Qiramarrësin me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, Qiramarrësi, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.



8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- a) në marrëveshje midis palëve;
- b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;
- c) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate;
- ç) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5.7 të kësaj kontrate;
- d) kur prona nevojitet për interes publik;
- dh) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të Qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse Qiramarrësi nuk ka reaguar me shkrim. Qiramarrësi detyrohet të dorëzojë objektin 15 ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim të Qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës.

8.4 Palët bien dakord dhe marrin përsipër të bëjnë çdo përpjekje, që për çdo çështje të lidhur me përmbushjen e kësaj kontrate apo edhe me të gjitha elementet e vlefshmërisë dhe interpretimit të saj, ta zgjidhin me marrëveshje midis tyre. Në këtë rast çdo ndryshim do të pasqyrohet formalisht me shkrim dhe mbas nënshkrimit do të konsiderohet pjesë integrale e kësaj kontrate.

Neni 9

Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga Qiramarrësi, sipas pikave 5.7, 5.8, 5.9 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta me Qiradhënësin, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga ekspert i kontabël i miratuar/ auditues ligjor sipas rastit.

9.3 Qiramarrësi dhe Qiradhënësi janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me “forcë madhore” do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta etj. dhe çdo ngjarje e paparashikuar që do të shpallet si e tillë me një akt

zyrtar. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 Qiramarrësi përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimin të forcës madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10

Dispozita të fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t’u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur para komisionit të konkurrencës dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësi administrative dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji, nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen Qiramarrësit.

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë të nenit 801 e në vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI
Ministria e
Ekonomisë, Kulturës
dhe Inovacionit

QIRAMARRËSI
“Investment and
Development Albania”
sh.p.k.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8561055019
(Nga 8561054159, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8561, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 1/911, Sipërfaqja Totale 10000 m²,
(Nga të Cilat Truall 10000 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale KO-I-9, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia KORÇË, Rruga -, Ndërtesa Nr. -, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 301, Dt. 19/05/2021), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, Nr. Identifikimi/NIPT SG463975699, Pjesa Takuese 1/1,
Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia -, Rruga -, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 301, Datë: 19/05/2021

Regjistruar: Nr. 00024653, Datë: 22/06/2021

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____, me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. __, Datë: ____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____

Regjistruar: Nr. __, Datë: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfutues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/NIPT
00024653	22/06/2021	Administrim	VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit	301	19/05/2021	999 vite	MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	SG656439884

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfutues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: ME VKM NR.433/2023 KJO PASURI ESHTË TRASFERUAR PER LLOGARI TE FONDIT TE PASURIVE TE PALUAJTESHME PER MBESHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

DREJTORI
Eni Polena



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore KORÇE-DEVOLL-KOLONJE
Date: 2025/05/22 14:58:57 +02'00'
J91326001G2025052214585029ASHK

Klaudja
Xite

Digitally signed by:
Klaudja Xite
Date: 2025.05.22
02:59:27 +02'00'

Jurgen
Gegollari

Digitally signed by:
Jurgen Gegollari
Date: 2025.05.22
04:03:16 +02'00'

Digitally signed by:
Eni Polena
Date: 2025.05.22
04:23:54 +02'00'

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2



RILEVIMI TOPOGRAFIK I PRONËS SE BASHKISË KORÇË

SHKALLA 1:1000

FUSHE SPORTI

SUPERFAQE TRUALL TOTALE : 10000m²

ZONA KADASTRALE KSHI
 INDEKS HARTE: NOJ/9
 ADRESA KURC
 Nr. Pks. 1981 me Superfaqe 10000m²



FUSHE SPORTI

PASURIA 1/944


Sip: 10000m²

SISTEMI I KOORDINATAVE-UTM

FUSHE SPORTI

POZICIONIMI I PRONËS MBI ORTOFOTO

SHKALLA 1:2000



Digitally signed by

Erdit Salillari

Erdit

Salillari

Date: 2025.01.10
 Punoi: Ing. Erdit Salillari
 NR. 09.39.33.002.000
 NR. 09.39.33.002.000

Date: 25.01.2019

**VENDIM**

Nr. 328, datë 11.6.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 127, DATË 3.3.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun III, të vendimit nr. 127, datë 3.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 7, fjalët “...legjislacioni për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij...” zëvendësohen me “...Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë dhe rregullorja e brendshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve...”.

2. Në pikën 8, fjalët “... në shërbimin civil ...” zëvendësohen me “...në sistemin e burgjeve...”.

3. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale rregullohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.”.

II. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

URDHËR

Nr. 574, datë 9.6.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
MURTAJËS SË RUMINANTËVE
TË VEGJËL**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panairë dhe grumbullime të tjera.

2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuar në fermën e prekur nga sëmundja.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imëta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluar nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privatë dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	Rrethi	Njësia administrative	Fshati
3 km			
1	Dibër	Martanesh	Ndërfushas
2	Dibër	Martanesh	Melcu
3	Dibër	Martanesh	Val
10 km			
4	Tiranë	Shëngjergj	Shëngjergj
5	Tiranë	Shëngjergj	Bizë
6	Dibër	Martanesh	Ballenj
7	Dibër	Martanesh	Lenë
8	Dibër	Martanesh	Peshk
9	Dibër	Martanesh	Gjon
10	Dibër	Martanesh	Krastë
11	Dibër	Martanesh	Stavec
12	Dibër	Klos	Plani bardhë
13	Dibër	Klos	Shëngjun
14	Dibër	Klos	Klos katund
15	Dibër	Klos	Fshat
16	Dibër	Xibër	Petralbë



8. Intensifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 575, datë 9.6.2025

**PËR NDALIMIN E PËRKOHSHËM TË
LËVIZJES SË KAFSHËVE TË GJALLA
TË LLOJIT DHEN DHE DHI NË
TERRITORIN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në shkronjën “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, nga ferma në fermë, shtegtimin dhe kullotjen në kullota, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ndalimin përkohshëm të tregtimit të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi në tregjet e kafshëve të gjalla, mjedise të hapura, panairë dhe grumbullime të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Lejohet lëvizja e kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi vetëm për në thertore, e shoqëruar me certifikatë shëndetësore veterinare, e lëshuar nga veterineri zyrtar.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së

Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 47/2024, datë 16.5.2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në fushën e sigurimeve shoqërore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 103, datë 21.6.2024, në aneksin 1 bashkëlidhur marrëveshjes bëhet ndreqja e gabimit si më poshtë: shtohen paragrafi i fundit i pikë 3 dhe pikat e munguara 4, 5, 7 dhe 8.

Secili Autoritet do të shpërndajë informacionet e sipërpërmendura në faqen e tij të internetit, së bashku me Marrëveshjen. Një kopje e informacionit do të përfshihet, gjithashtu, në komunikimet individuale për të Interesuarit, si edhe një referencë në faqen e internetit të sipërpërmendur.

4. Siguria dhe konfidencialiteti

Secili Autoritet do të zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale të marra nga akseset aksidentale ose të paligjshme, asgjësimi, humbja, ndryshimi ose zbulimi i paautorizuar. Masat e sipërpërmendura do të përfshijnë masa të përshtatshme administrative, teknike dhe fizike të sigurisë. Këto masa duhet të përfshijnë klasifikimin e të dhënave personale në të dhëna të zakonshme, të veçanta dhe penale, kufizimin e subjekteve të pranuar për të hyrë në të dhënat personale, ruajtjen e sigurt të të dhënave personale sipas llojit të tyre dhe miratimin e politikave që synojnë të sigurojnë që të dhënat personale mbahen të sigurta dhe konfidenciale, duke përfshirë përdorimin e teknikave të pseudonimit ose enkriptimit. Për menaxhimin e të dhënave të veçanta dhe penale duhet të merren masa sigurie më rigorozë, duke përfshirë, ndër të tjera, aksese më selektive dhe trajnim të specializuar të punonjësve.



Në rast se një autoritet marrës merr dijeni për një shkelje të të dhënave personale, ai do të informojë Autoritetin transferues brenda 48 orëve dhe do të marrë masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për ta korrigjuar atë dhe për të minimizuar efektet e mundshme negative për të Interesuarit, duke përfshirë komunikimin me të lartpërmendurit, pa vonesa të pajustificueshme, në lidhje me shkeljen, nëse kjo mund të sjellë për pasojë një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e tyre.

5. Mënyrat e ushtrimit të të drejtave

Secili Autoritet do të marrë masat e duhura që, me kërkesë të një të Interesuari, të mundet:

1. të konfirmojë nëse përpunon ose jo të dhënat personale në lidhje me të dhe, nëse po, të japë akses në të dhëna të tilla, si edhe të japë informacione mbi përpunimin e tyre, duke përfshirë informacionin për qëllimet e përpunimit, kategoritë e të dhënave të marra në konsideratë, prejardhjen dhe marrësit e të dhënave, periudhën e parashikuar të ruajtjes dhe mundësitë e ankesës dhe ankimit;

2. të identifikojë të gjitha të dhënat personale të aplikantit, i cili ia ka transferuar Autoritetit tjetër sipas këtyre Klauzolave;

3. të japë informacione të përgjithshme, edhe në faqen e tij të internetit, në lidhje me garancitë e zbatueshme për transferimet tek Autoriteti tjetër.

Secili Autoritet do t'i përgjigjet në mënyrë të arsyeshme dhe në kohë një kërkesë të një të Interesuari në lidhje me korrigjimin, anulimin, kufizimin e përpunimit ose kundërshtimin e përpunimit të të dhënave të veta personale ose ushtrimin e së drejtës për të mos iu nënshtruar vendimeve të automatizuara. Të dhënat e kontaktit të postës së zakonshme ose asaj elektronike për dërgimin e kërkesave të sipërpërmendura duhet të tregohen në informacionin e përgjithshëm për të Interesuarit, sikurse parashikohen në pikën III.3. mbi transparencën. Një Autoritet mund të zbatojë masat e duhura, si, për shembull, vendosjen e një tarifë të arsyeshme për të mbuluar kostot administrative të kërkesës ose refuzimin për ta ndjekur atë, nëse kjo do të rezultonte haptazi si e pabazuar ose e tepruar.

Secili Autoritet mund të përdorë procedura të automatizuara për të përmbushur në mënyrë më efektive qëllimet e veta, me kusht që të ilustrojë

arsyet dhe të japë shpjegime të rëndësishme në lidhje me logjikën e përdorur. Në këtë rast, duhet të merret pëlqimi paraprak dhe i qartë i palëve të interesuara ose duhet të njihet e drejta për të mos iu nënshtruar një procesi vendimmarrjeje të automatizuar. Sidoqoftë, të Interesuarit kanë të drejtë të korrigjojnë informacionet e pasakta ose jo të plota në lidhje me ta dhe të kërkojnë rishikimin e një vendimi të automatizuar nëpërmjet një ndërhyrjeje njerëzore.

7. Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave

Autoritetet do të ruajnë të dhënat personale për kohën e parashikuar nga kërkesat ligjore në fuqi, të cilat duhet të parashikojnë për një periudhë kohore që nuk e kalon atë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat.

8. Mbrojtja administrative dhe gjyqësore

Nëse një i Interesuar beson se një autoritet nuk i ka respektuar garancitë e parashikuara në këto Klauzola ose se të dhënat e tij personale t'i jenë nënshtruar përpunimit të paligjshëm, ai ka të drejtë të ankohe pranë një Autoriteti mbikëqyrës dhe të marrë mbrojtje gjyqësore nga një Autoritet gjyqësor, në përputhje me kërkesat ligjore të zbatueshme në juridiksionin në të cilin ka ndodhur shkelja e pretenduar. I Interesuari, gjithashtu, ka të drejtën e kompensimit për çdo dëm të pësuar.

Në rast të një mosmarrëveshjeje ose pretendimi të paraqitur nga një i Interesuar kundër Autoritetit transferues, Autoritetit marrës ose të dy Autoriteteve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të të Interesuarit, autoritetet do t'i japin njëri-tjetrit informacione mbi këto mosmarrëveshje ose pretendime dhe do të angazhohen për të zgjidhur mosmarrëveshjen ose pretendimin në mënyrë miqësore në kohën e duhur.

Nëse një i Interesuar ngre një kritikë dhe Autoriteti transferues vlerëson se Autoriteti marrës nuk ka vepruar në përputhje me garancitë e parashikuara në këto Klauzola, Autoriteti transferues do ta pezullojë transferimin e të dhënave personale tek Autoriteti marrës derisa të vlerësojë se ky i fundit e ka zgjidhur problemin në mënyrë të kënaqshme. Autoriteti transferues do të informojë të Interesuarin dhe Autoritetin e tij mbikëqyrës për zhvillimet e çështjes.



IV. Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrja e jashtme e zbatimit të drejtë të këtyre Klauzolave sigurohet nga autoritetet mbikëqyrëse.

2. Secili Autoritet do të kryejë rishikime periodike të politikave dhe procedurave të tij në zbatimin e këtyre Klauzolave dhe efektivitetit të tyre. Me një kërkesë të arsyeshme nga një Autoritet, Autoriteti të cilit i është drejtuar kërkesa do të rishqyrtojë politikat dhe procedurat e tij të përpunimit të të dhënave personale për të verifikuar dhe konfirmuar se garancitë e parashikuara në këto Klauzola janë zbatuar në mënyrë efektive. Rezultatet e rishikimit do t'i komunikohen Autoritetit që ka kërkuar rishqyrtimin.

3. Në rast se një Autoritet marrës nuk është në gjendje, për çfarëdolloj arsyeje, të zbatojë efektivisht garancitë e parashikuara në këto Klauzola, ai do të informojë pa vonesë Autoritetin transferues, në këtë rast ai do të pezullojë përkohësisht transferimin e të dhënave personale tek Autoriteti marrës, derisa ky i fundit të konfirmojë se është sërish në gjendje të veprojë në përputhje me garancitë e sipërpërmendura. Në lidhje me këtë, autoritetet pritëse dhe transferuese do të mbajnë të informuara autoritetet e tyre mbikëqyrëse përkatëse.

4. Në rast se Autoriteti transferues vlerëson se Autoriteti marrës nuk ka vepruar në një mënyrë të pajtueshme me garancitë e parashikuara në këto Klauzola, Autoriteti transferues do ta pezullojë transferimin e të dhënave personale tek Autoriteti marrës, derisa të gjykojë se ky i fundit e ka zgjidhur çështjen në mënyrë të kënaqshme. Në lidhje me këtë, Autoriteti transferues do ta informojë vazhdimisht Autoritetin e vet mbikëqyrës.

V. Rishikimi i klauzolave

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

